



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

Më datë **29.11.2018**, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin Policor për Kontroll Kufitar Aerodrom Shkup.

Vizita buron nga mandati i Avokatit të Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional, e cila është parashikuar në Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Veprimeve tjera Brutale, Johumane, Përçmuese ose Ndëshkuese. Me Protokollin Fakultativ definohet zbatimi i vizitave të rregullta në vendet ku mund të kryhet privimi nga liria i personave, me qëllim të identifikimit të rreziqeve dhe parandalimit të torturës ose llojeve tjera të veprimit brutal, jonjerëzor, përçmues ose ndëshkues.

Ekipi i MPN hasi në bashkëpunim dhe kooperim të mirë nga ana e personave zyrtarë të punësuar në Stacionin Policor, të cilët mundësuan qasje papengesë deri te të gjitha hapësirat dhe instalimet dhe këqyrje në dokumentacionin e kërkuar.

Gjatë këqyrjes në zyrat nuk ishin vërejtur mjete, e as sende të tjera të dyshimta me të cilat do të mund të kryhej frikësimi i personave të arrestuar, përkatësisht personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar.

Stacioni Policor për KK Aerodrom Shkup nuk ka hapësirë të veçantë për marrjen në pyetje të personave të arrestuar dhe personave të privuar nga liria, përkatësisht marrja në pyetje zhvillohet në sallën e takimeve.

Stacioni Policor për KK Aerodrom Shkup nuk ka në shërbim përkthyes të autorizuar për gjuhë të rralla (gjuhën arabe, urdu, pashtu dhe ngjashëm).

Ekipi i MPN konstatoi se nuk është adekuate vend-pozita e hapësirave për pushim të dedikuara për personat të cilët nuk i plotësojnë kushtet për hyrje në shtet, të cilët gjenden në pjesën e poshtme të ndërtesës së terminalit nën zonën transit, veçanërisht në aspekt të qasjes kufitare për hyrje-dalje në të njëjtat.

Ekipi i MPN në SP për KK Aerodrom Shkup për nëpunësit policorë organizon trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme me përmbajtje tematike nga më të ndryshmet, ndërsa një pjesë e nëpunësve zyrtarë më me përvojë mbajnë trajnime si mentorë, ndërsa një pjesë e nëpunësve policorë marrin pjesë në organizime ndërkombëtare nga fushëveprimi i punës së tyre (Fronteks) dhe në mënyrë aktive ndjekin trajnime të specializuara.

Stacioni Policor për KK Aerodrom Shkup nuk ka hapësirë të posaçme për azilkërkuetit, si dhe nuk ka formularë për shprehjen e qëllimit për të paraqitur kërkesë për azil, e as nuk janë vërejtur informata të vendosura për azilkërkuetit.

Gjithashtu, qasja në listën e avokatëve të regjistruar në kalendarin e Avokatëve të lëshuar nga Dhoma e Avokatisë së RMV, në rastet kur të thirrurit, të arrestuarit dhe personat e privuar nga liria, dëshirojnë ta shfrytëzojnë të drejtën për të thirrur mbrojtës.

Ekipi i MPN konstatoi se vërehet informim i pamjaftueshëm i nëpunësve policorë nga fusha e azilit dhe nivel i lartë i njohjes së masave që kanë të bëjnë me referimin e personave të cilët kanë nevojë ose qëllim të kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.

Ekipi i MPN konstatoi se ka nivel të ulët të njohurive tek personat zyrtarë për Procedurat Standarde Operative për trajtimin e kategorive vulnerabile të personave-të huaj dhe Procedurat Standarde Operative për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar fëmijë-të huaj.

Ekipi i MPN konstatoi se higjiena në hapësirat e Stacionit Policor për Kontroll Kufitar Aerodrom Shkup ishte në nivel përkatës.

Ekipi i MPN konstatoi e Evidenca në SP për KK Aerodrom Shkup mbahet pastër, qartë dhe në rregull dhe konform rregullave për punë zyre. Në librat e evidencës nuk shfrytëzohet fare llaku korrektues, dallohet rrjedha kronologjike e ngjarjeve të evidentuara dhe nuk ekziston rikapitimi.

Për vizitën, Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe drejtoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te eprori i Stacionit Policor, me qëllim

që të eliminohen mangësitë e theksuara dhe të përmirësohen kushtet dhe veprimi me personat e privuar nga liria, personat e paraburgosur dhe personat e ndaluar.